



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **49**

Prishtinë, më 16.6.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Zef Morina.

Munguan :Zulfi Merxha (ka arsyetuar mungesën), Dragiša Mirić, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga Departamenti ligjor i Kuvendit Xheladin Hoxha, nga OSCE Maria Berishaj dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shpjegimi i Dep. ligjor të Kuvendit rreth emërimit të udhëheqësve të ZRRUM,
3. Fondi financiar i komisionit.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shpjegimi nga zyra ligjore e Kuvendit rreth emërimit të udhëheqësve të ZRRUM

Lulzim Zeneli menjëherë ftoi përfaqësuesin e Departamentit ligjor **Xheladin Hoxhën** për të sqaruar rreth kërkesës së komisionit, i cili theksoi se departamenti ligjorë mund të konfirmoi se vendimi i Qeverisë për emërimin e dy të rekomanduarëve është e ligjshme, ndërkaq ky departament nuk është i autorizuar të interpretoj se çka nënkuptohet me “kualifikim i duhur personal” dhe “integritet më të lartë”, poashtu komisioni mund të kërkoj informacione shtesë për të dëshmuar kualifikimin e duhur profesional të kandidatit Kero Bardhaj, ngase në CV-në e bashkëngjitur nuk është një dokument i tillë që dëshmon kualifikimin për këtë kandidat.

Lulzim Zeneli falënderoi dhe shtoi se komisionit ju është rekomanduar për këto dy emra, ndaj ishte i mendimit se normale është që nuk mund të ketë pajtime në komision, për këtë

arsye propozoi ti procedohen Kuvendit për miratim. Edhe **Naim Maloku** ishte i pajtimit se mirë është të veprimi ashtu komisioni, ngase grupit parlamentar të AAK do ti sugjerohet nga ai të votojnë kundër. **Berat Luzha** tha se komisioni mund të kërkojë dokumente shtesë, mirëpo kryetari sqaroi se kjo nuk është e nevojshme pasi që kemi të bëjmë me vendim të Qeverisë e bazuar në procedurën e përcaktuar.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. **I rekomandohet Kuvendit të Kosovës për miratim vendimi i Qeverisë me të cilin janë rekomanduar Raif Preteni Drejtor dhe Kero Bardhaj zëvendës drejtor i ZRRUM.**
2. **Secili deputet i Kuvendit të Kosovës e ndanë mendimin personal me anë të votës si dhe kërkon informata (dokumente) shtesë nëse ka nevojë, pasi që fjala është për një vendim të Qeverisë.**

3. Fondi financiar i komisionit

Lulzim Zeneli njoftoi komisionin se pak më parë ka kontaktuar me Sekretarin e Kuvendit i cili ka njoftuar se komisioni i kërkon mjetet financiare nga fondi me kërkesë dhe me arsyetim për shpenzim, ndaj konstatoi se komisioni mund ti arsyetoi ato për periudhën e shtatorit (ndonjë aktivitet apo vizitë), ngase tani nuk ka kohë për të realizuar ndonjë plan.

Berat Luzha saktësoi se fjala është për 50% të mjeteve që është deshtë të planifikohen për 6 mujorin e parë, përndryshe humbin, por nëse nuk humbin atëherë mund të mbetet për shtatorë realizimi i tyre, dmth 50% të mjeteve duhet të shpenzohen në 6 mujorin e parë.

Zef Morina shkurtimisht sqaroi se si është në komisionin tjetër ku është ai anëtarë, mirëpo tha më mirë është të mirën informatat shtesë, përndryshe ai komision ka marr një këshilltarë juridik i cili do të paguhet me pagë dhe do të këshillojë komisionin.

Lulzim Zeneli konstatoi që komisioni të kërkojë nga sekretaria informatë shtesë, dhe të hartohet plani pastaj. **Selviqe Halimi** ngriti çështjen e mbështetjes nga stafi të këtij komisioni me pyetjen konkrete : pse koordinatori i Komisionit nuk i ka edhe dy zyrtar ndihmës.

Xheladin Hoxha tha se zyrtarisht Bajram Badivuku e ka ndihmëse zyrtaren Drita Çarkaxhiun por marrëveshjet interne kanë ndryshuar pamjen e ndihmësve të komisioneve.

Bajram Badivuku tha se një staf fillimisht është caktuar prej 4 zyrtarëve, por këtu janë caktuar 3 zyrtar për çka është reaguar me kohë (edhe z. Naim Maloku ka qenë në mbledhjen e stafit ku Bajram Badivuku ka kërkuar plotësimin e stafit të komisionit) , që do të thotë se me kohë sekretaria i ka pasur borxh një punëtorë për komisionin e bujqësisë. Kjo është premtuar dhe tani është dërguar praktikanti Mustafë Nuhiu, i cili fatkeqësisht është vetëm për 6 muaj sipas kontratës në këtë Kuvend.

Naim Maloku tha se nuk ka ndonjë vërejtje në punën e tanishme të stafit, përkundrazi rregullisht bëhen njoftimet edhe në imejlat privat, përveç atyre zyrtarë.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. **Të premtën më 19.6.2009 në orën 11,00 mbahet mbledhja e komisionit ku do të shqyrtohet informata shtesë nga sekretaria për çështjen e fondit financiar të komisionit, pastaj do të hartohet plani i realizimit, si dhe mbështetja nga stafi i këtij komisioni me pyetjen konkrete : pse koordinatori i Komisionit nuk i ka edhe dy zyrtar ndihmës.**

2. **Përfaqësuesi prezent i Departamentit Ligjor z. Xheladin Hoxha do të përcjellë në sekretari kërkesën e komisionit rreth informatës shtesë rreth fondit financiar të komisionit, për tu përgatitur përgjigja deri në mbledhjen e radhës.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,50, mbledhja e radhës do të mbahet më 19.6.2009 në orën 11,00.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli